



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

**PAKR.nr.39/22**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Tonka Berishaj – Kryetare e kolegjit, Vaton Durguti dhe Bashkim Hyseni – anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesional Syzana Goxhuli, në çështjen penale ndaj të akuzuarit N.B, nga fshati-...-Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale; Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, më tutje shkurtesa (KPRK-së), si dhe për veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP.I.nr.1/2015 e dt.14.03.2016, e ka ri-kualifikuar nga prokuroria në veprën penale në pikën I të aktakuzës, si vijon, në veprën penale; Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.4 dhe 1.6 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.1/2015 të datës 26.11.2021, dhe përgjigjes në ankesë e përbashkët të mbrojtëseve e të akuzuarit N.B-av.Ramiz Krasniqi dhe Visar Vehapi, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore –DKR në Mitrovicë, P.nr.113/19 të datës 19.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, më datë 26.01.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Me aprovimin** si të bazuar të ankesë së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - DKR, e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.113/19 i datës 19.11.2021, **ANULOHET** dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin P.nr.113/19 të datës 19.11.2021, të akuzuarin N.B, në pikën I të dispozitivit bazuar në

dispozitën e nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, e ka liruar nga akuza për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.4 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale janë lënë në barë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate. Të dëmtuarit familjaret e të ndjerit, për realizmin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil. Po ashtu për piken I të dispozitivit bazuar në dispozitën e nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, të akuzuarin e ka liruar nga akuza për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale janë lënë në barë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate. Kërkesë pasurore-juridike, nuk kishte pasur për këtë pikë

Në afat ligjor ankesë ka paraqitur Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen penale të kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kanë parashtruar mbrojtësit e të akuzuarit N.B, av.Ramiz Krasniqi dhe av.Visar Vehapi, me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.55/22 të datës 21.01.2022, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa përgjigja në ankesën e PTH në Mitrovicë e mbrojtëseve të akuzuarit N.B, avokatet Ramiz Krasniqi dhe Visar Vehapi, të refuzohet si e pabazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës të nenit 390 par.1 të KPPRK-së, për të cilën nuk i njoftoi palët pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka shqiptuar dënimin me burgim por e ka liruar nga akuzua, prandaj njoftimi i palëve nuk është i detyrueshëm.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës në këtë çështje së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuar në ankesë dhe përgjigjes në ankesë, gjeti se: **Ankesa është e bazuar.**

## **Pretendimet ankimore**

Prokuroria në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte ka marrë për bazë në rastin e vendosjes dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Sipas prokurorisë, gjykata nuk përjashton mundësin që një palë çelësa tjerë të derës së hyrjes (kapigjikut) në oborrin e shtëpisë së H.B ti këtë pasur dikush tjetër përveç çelësave që i ka poseduar N.B ashtu që lidhur me këtë gjykata nuk mund të mbështetet në supozime duke konstatuar se nuk e përjashton mundësinë por duhet të vërtetoj faktet, po ashtu gjykata nga raporti i policisë së Kosovës ka vërtetuar që G.B ka ndërruar dyert dhe dritaret në kompaninë “L.P”, por nuk paraqet dëshmi së për kënd janë ndërruar apo për cilën shtëpi janë ndërruar këto dyer të H. apo të G. Se H.B nuk ka bërë ndërrimin e dyerve dhe dritareve nga ana e G.B siç konstaton shkalla e parë apo blerjen e dyerve dhe dritareve siç konstatohet në raportin policor pasi që bërja dhe ndërrimi janë diametralisht të kundërta, po ashtu nga gjykata konstatohet se nuk dihet a ka pasur qelës tjetër H.B, prandaj nëse nuk dihet se a ka pasur çelës tjetër H.B gjykata duhet ta marrë si të mirëqenë vetëm ekzistim e çelësit i cili është gjetur tek i akuzuari.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike thekson se gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur ja kushton besimin deklaratës së dëshmitarit H.B e G.B se ka ekzistuar edhe çelësi i tretë, për faktin se këta dëshmitarë e kanë vëlla të akuzuarin dhe se deklaratat shkojnë në favor të tij me qëllim të lirimit nga përgjegjësia. Ndërsa në anën tjetër sipas raporti të rreshterit R.M rezulton se me dt.26.10.2004 dëshmitari G.B ka paraqitur rastin e thyerjes së shtëpisë së H.B dhe se gjatë vjedhjes ka theksuar se është marrë një resiver digjital një TV dhe një studio mirëpo fare nuk është raportuar se është vjedhur një çelës kopje për të cilin pretendohet se ka ekzistuar, por i njëjti është përmendur vetëm pasi ka filluar procedura penale ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se kush e ka poseduar apo kush ka qenë në posedim të çelësit kopje dhe ky fakt tregon se çelësi nuk ka ekzistuar por është imagjinuar me qëllim të përjashtimit të përgjegjësive penale të pandehurit. Përveç kësaj nga ana e laboratorit K-L është bërë krahasimi i mostrës së benzinës marrë nga pompa “B.P”, në Pejë nga automjeti Hammer që ishte në posedim e të akuzuarit rezulton se ka përputhshmëri të plotë se automjeti është mbushur me benzinë pikërisht në këtë pompë e që vërtetohet edhe nga deklarata e ekspertit N.M e dhënë në shqyrtimin gjyqësor. Po ashtu provë tjetër është fakti se nga automjeti Hammer janë marrë mostrat e gjurmëve të gishtërinjve dhe nga ato mostra

është nxjerr profili i ADN-së nga i akuzuari N.B e që vërtetohet edhe nga deklarata e ekspertes H.M e cila konstaton se është ekzaminuar një kapak i plastikës me ngjyrë të zezë marr nga rezervari i automjetit HAMMER me tabela New York i cili përputhet me profilin e të akuzuarit, pastaj konstatohet se i akuzuari nuk mund të përjashtohet si kontributor i ADN-së në këtë dëshmi gjasa e paraqitjes se këtij profili në popullacion janë një në 2700 bilion në individ nga këto arsye si mund të shpjegohet fakti se i akuzuari nuk ka kryer vepër penale. Tutje ka shtuar se i është e mundur që në mëngjes të ndizet automjeti dhe nuk u dëgjuar asnjë zhurmë, si është ndez automjeti nga garazha çelësat e se cilës garazh i ka poseduar i akuzuari, si ndodhi që automjeti sipas të pandehurit në momentin e parkimit ka qenë në pjesën e përparme nga rruga, ndërsa ditën e nxjerrjes nga policia i parkuar në anën e kundërt, si ndodhi që sipas të akuzuarit automjeti ka pasur benzinë në vlerë prej 10 euro ndërsa ditën kur është marr nga policia ishte i mbushur tërësisht, pastaj në kohën kur është nxjerr automjeti nga garazha ka qenë kohë me të reshura e me borë me trashësi të borës rreth 30 cm e nuk shihen gjurmët e rrotave të automjeti, prandaj nga praktika e me hershem nuk ka ndodhur që të shfrytëzohet automjeti për vrasje e të kthehet në garzh, kur kemi të bëjmë me kohë me ngrica, trashësia e borës deri në 30 cm dhe shtëpitë e vëllezërve të N.B janë të renditura njëra pas tjetrës. Tutje shton se meqenëse shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të paraqitur më lartë janë ngushtë të lidhura me vërtetimin e gabuar të gjendje faktike dhe drejt për drejt kanë ndikuar në aplikimin e gabuar të ligjit penal, për arsye të lartcekura ka pozuar si me lartë.

### **Përgjigje në ankesë:**

Mbrojtësit e të akuzuarit av. Ramiz Krasniqi dhe av.Visar Vehapi në përgjigje në ankesë theksojnë se as nuk duhet të trajtohet ankesa e PTH-së, pasi që nuk i plotëson kriteret minimale të trajtohet si e tillë, ngase prokuroria përmes ankesës tenton ti shtrembëroj faktet e gjetura në aktgjykim. Sipas mbrojtëseve çfarë rëndësie ka se kush e posedonte çelësin e derës se hyrjes në shtëpinë e H.B, çfarë rëndësie kanë rëndësi mostrat e ADN-së, për faktin se të njëjtat çështje janë trajtuar me kujdes në aktgjykim, ndërsa në rastin konkret prokurori nuk e trajton çështjen thelbësore në fjalë se a është vërtetuar se i personi që e privoj nga jeta tani të ndjerin ishte N.B, ngase të gjitha ekspertizat e kryera lidhur me këtë rast që kanë të bëjë me ekzaminimin e video incizimeve nuk kanë arritur të përcaktojnë se personi që shihet në video është tani i akuzuari, ndërsa automjeti Hammer mund të ndizet edhe me çelësa të kopjuar.

## **Gjetjet e Gjykatës së Apelit:**

Gjykata e Apelit, pasi analizoi dhe vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në drejtim të pretendimeve ankimore të prokurorisë së shtetit, gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara meqenëse aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara në nenin 384 të KPPRK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, kjo pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin e në të cilin nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare të cilat i ka vërtetuar apo nuk i ka vërtetuar, e në anën tjetër arsyetimi është në kundërshtim me shkresat e lëndës si dhe arsyet në të cilat është bazuar në rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike dhe përgjegjësinë penale e të akuzuarit.

Gjykata e Apelit gjen se qëndron pretendimi ankimor i prokurorisë se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale duke mos dhënë arsye të qarta dhe të plota nëse fakti i ekzistimit apo jo të një palë të çelësave tjerë të derës së hyrjes (kapigjikut) në oborrin e shtëpisë së H.B ti këtë pasur dikush tjetër përveç çelësave që i ka poseduar N.B, kjo nga fakti se gjykata nuk ka eliminuar kundërthëniet në mes të vet deklaratës së dëshmitarit G.B dhe raportit të policës, që ai ka ndërruar dyert dhe dritaret, ndërsa në anën tjetër në deklarinimin e tij, fq.568 të shkresave të lëndës, ka theksuar se “*ai ( është fjala për H.B) i ka ndërruar të gjitha çelësat të derës së vogël, dera e madhe nuk ka pas çelës dhe ma nuk i kanë pas këta çelësat në dorë*” pra, nga kjo rezulton se nuk është vlerësuar saktësia e provave kundërthënëse, dhe rrjedhimisht rezulton se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkeljen esenciale të dispozitës nga neni 384 par.1 nën par.1.12 e lidhur me nenin 370 par.7 të KPPRK-së.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, në fq.30, gjykata e shkallës së parë, pos tjerash konstaton se *me besueshmëri të lartë ka ekzistuar edhe një çels tjetër për këtë automjet, dhe në rrethanat e lëvizjes së çelësave të automjetit “Hamer”, gjykata nuk përjashton mundësin që çelësat e automjetit janë kopjuar apo shumëzuar për qëllimet të caktuara*, ndërsa në anën tjetër në fq.31 pasuesi 3 gjykata konstaton se pretendimet e prokurorisë se kanë ekzistuar vetëm dy çelësat të automjetit “Hamer”, se këta dy çelsat i ka poseduar vetëm N.B, nuk mund të qëndroj, sepse provat tregojnë një gjendje tjetër faktike. Më tej thekson se gjykata nuk ka arritur që të vërteton se kush e ka poseduar apo se kush ka qenë në disponim të çelësit tjetër apo çelësit të

tretë të automjetit “Hamer”, përveç se nga dëshmia e dëshmitarëve vërtetohet se ky çelës ka qenë për një kohë në shtëpinë e H.B.

Mirëpo, sipas vlerësimit të kësaj gjykata, si me të drejtë pretendon prokuroria në ankesën e saj, ky fakt ka mbetur në nivel të dubiozitet në raport me provat nga shkresat e lëndës e për të cilat gjykata e shkallës së parë nuk i ka eliminuar për të vërtetuar këtë me saktësi të plotë për çka rrjedh se aktgjykimin e ankimuar e bënë që si të tillë të jetë përfshirë me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nenin 384 par.1 nënpar.1.12 e lidhur me nenin 370 par.7 të KPPRK-së e kjo për faktin se;

Në dëshminë e tij dëshmitari G.B, fq.569 të shkresave të lëndës, pos tjerash ka dëshmuar, duke theksuar, se dëshmitari- H.B, “mka thënë se baba i ka pas çelësat dhe baba e ka ba një kopje vetëm çelsin”.

Këtë fakt të kumtimit nuk e pohon kështu dëshmitari H.B në dëshminë e tij, ngase ai në dëshminë e tij të dhënë në procesverbal në Prokurori të shteti më datë 10.04.2015, në asnjë pjesë të deklaratës nuk thekson se këtë ia kishte kumtuar dëshmitarit G.B. Përkundër kësaj ai në deklarin e tij ka theksuar “para se me ja marrë çelsat më ka humb televizori, stereo, lodra të fëmijëve. Qelsat e shtëpisë i ka pasur G.. Qelsi rezerve ka qenë në shtëpi”.

Në anën tjetër dëshmitari H.B në dëshminë e tij të dhënë në prokurori dëshmon se në vitin 2007, në Kosovë, e ka kishte sjellë veturën Hamer për nevojat e tij. Pasi i ka vdekur baba në vitin 2009, para se të kthehej qelsat ia kishte lënë vëllait të dytë Gëzimit. Në periudhën 2012-2013 ia kishte marrë qelsat G... Para se me ja mare qelsat e shtëpisë i ka pasur Gëzimi. Qelësi rezerv ka qenë në shtëpi.

Për këto fakte të pohuar ndryshe nga njëri tjetri nga këta dëshmitar, nga arsyetimi i aktgjykimin të ankimuar, fq. 27-28, rezulton që sipas raportit të policisë-Stacioni në Pejë të “njofton se shtetasi H.B nuk ka paraqitur asnjë rast të vjedhjes apo dëmtimit të pasurisë, mirëpo personi G.B, më 26.10.2004, ka paraqitur një rast të vjedhjes së pajisjeve elektronike në shtëpinë e vëllait të tij, H.B i cili ka jetuar dhe jeton në Amerikë”.

Nga këto dëshmi në raport me këtë njoftim policor rezulton se nuk është eliminuar kjo paqartësi për të vërtetuar me saktësi përkitazi me ekzistimin e një çelsi tjetër-çelësi të tretë e që ishte në

shtëpinë e H.B, për faktin se është pikërisht rasti i vjedhjes si i referohet dëshmitari H.B në dëshminë e tij e të cilën e kishte raportuar dëshmitari G.B në polici, sipas të cilit nuk vërtetohet se është paraqitur se ishte vjedhur edhe një çelësi i kësaj veture, ndërsa në anën tjetër kjo rrjedh që është në kundërshtim edhe me kohën kur ishte sjellë automjeti Hamer në Kosovë nga H.B, i cili pra, automjet ishte sjellë në vitin .... ndërsa vjedhja në shtëpinë e tij kishte ndodhur më ....., pra vetuar, kuptohet dhe çelsat e kësaj veture, ishin sjellë në Kosovë për gati 3 vite pas ngjarjes të raportuar të vjedhjes për të cilën gjykata konstaton se për një kohë një çels-i tretë kishte qenë në shtëpinë e H.B.

Andaj, në këto rrethana konstatimi nga gjykata e shkallës së parë se ka ekzistuar edhe një çelsë tjetër-i tretë bazuar në faljen e besimit të dëshmisë së dëshmitarëve në raport me këtë njoftim të policisë ka mbetur në nivel kontradiktor, të paqartësisë dhe saktësisë së vërtetimit të këtij fakti relevant për këtë çështje penale.

Gjykata e Apelit gjen se në aktgjykimin e ankimuar, fq.50, nuk është dhënë arsye të qartë dhe të plotë përkitazi me provën materiale të administruar në shqyrtimin gjyqësor, me nr.39. raportit të policisë mbi analizën e thirrjeve telefonike, listingut të thirrjeve dhe hartografisë së numrit të telefonit 044/808-773, numër të cilën e ka prezantuar i dyshuari N.B e për të cilën VALA ka siguruar të dhënat që abonenti i këtij numër është N.B nga fsh... K-D ....., por gjykata në arsyetim është fokusuar vetëm në atë se ky numër nuk ka bërë asnjë thirrje në antenat të cilat kanë mbulueshmëri mbi vendin e ngjarjes. Mirëpo, sipas këtij raporti të policisë për numrin e telefonit në fjalë rrjedh të mos jetë eliminuar kundërthënia në mes të tij dhe asaj se i akuzuari në ditën kritike nuk kishte lëvizur jashtë ambientit të shtëpisë së tij në kohën kur vetuar Hamer kishte rrëshqitur në kanal në dalje të fshatit ....., ku sipas këtij raporti të policisë ky numër i telefonit kishte aktivizuar antenën me mbulueshmëri të këtij fshati, e për të cilat rrethanat janë dëgjuar edhe dëshmitarët B. M. dhe T.S andaj, në këto rrethana rezulton se aktgjykimi është përshirë me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 e lidhur me nenin 370 par.7 të KPPRK-së, nga e cila rezulton se nuk është analizuar dhe vlerësuar saktësia e provave kundërthënëse të lartcekura për vërtetimin e fakteve vendimtare për këtë çështje penale.

Gjykata e Apelit vëren se, nga arsyetimi i aktgjyqimit të ankimuar, fq.22. në raport me dëshmitarin G.B për vërtetimin e fakteve relevante të kësaj çështje penale gjykata e shkallës së parë e ka bazuar edhe në deklaratën e tij në cilësinë e të dyshuarit të dhënë në polici më datë

03.01.2015. Kjo situatë është në kundërshtim me kodin e procedurës penale ku në mënyrë specifike përcakton të drejta dhe obligimet në raport me pozitën procedurale në një procedurë penale të çështjes konkrete. Personi që paraqitet në cilësinë e dëshmitarit paralajmërohet konform dispozitës së nenit 125 par.1. të KPPRK-së, se “...dëshmitari është i detyruar të dëshmoj, dhe të tregoj të vërtetën, ....” Të kundërtën e kësaj sipas nenit 125 par.3 të KPPRK-së, të pandehurit i lexohet paralajmërimi se “.....se keni të drejtë të heshti dhe të mos përgjigjeni në asnjë pyetje.... “ Pra, nga kjo rrjedh se deklarata që është dhënë në cilësinë e të dyshuarit nuk mund të shërbejë edhe për cilësinë e dëshmitarit e të njëjtit person, ngase obligimi ligjor i tij për të deklaruar për rrethanat që merret në pyetje ndryshojnë ku përderisa sa si dëshmitarë është i obliguar të përgjigjet dhe të tregoj të vërtetën, në cilësinë e të pandehurit ai mund të mos deklarohet dhe të mbrohet në heshtje dhe për këtë nuk tërheq asnjë pasoj procedurale si është situata me cilësinë e dëshmitarit. Andaj, nga kjo rezulton se aktgjykimi është përfshirë me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.2 të KPPRK-së dhe kjo ka ndikuar në marrjen e aktgjykimit të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet ti veçoj këto deklarata të personi apo personave të cilat i kanë dhënë si të dyshuar e që do të dëgjohen në cilësinë e dëshmitarit.

Duke qenë se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të lartcekura rrjedhimisht edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë si me të drejtë pretendon edhe prokuroria me ankesë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se në këtë çështje penale në fazën e hetimeve kanë dhënë dëshmi për faktet relevante të kësaj çështje penale edhe dëshmitarët E.M dhe T.M, për të cilat rrethanat e deklaruara nga ata për të dëshmuar sipas porosisë dhe kërkesë së dëshmitares N.B, ku gjykata e shkallës së parë e ka ballafaquar në shqyrtim gjyqësor dëshmitaren N.B me këto dëshmi mirëpo, për të vërtetuar në mënyrë të plotë këto fakte të rëndësishme gjykata e shkallës së parë do të duhej të dëgjoj dhe ballafaqoj këta dëshmitar për faktet e pohuara nga ata me qëllim që të vërtetoj nëse me të vërtetë është kontaktuar dhe kërkuar nga dëshmitarja N.B ashtu si kanë pohuar këta dëshmitar dhe se cili ishte qëllimi i kësaj kërkesë nga dëshmitarja N.B.

Gjykata e Apelit vëren se në fq.8 të aktgjykimit të ankimuar është konstatuar se është administruar edhe prova e incizimit nga kamerat e sigurisë që i përkasin objektit të pompës së derivateve “D-P.” i dt....., gjegjësisht kohës dhe vendit që i referohet ngjarjes së ditës kritike, në anën tjetër në shqyrtim gjyqësor është dëgjuar edhe dëshmitari E.Z të cilit i janë parashtruar,



ndër të tjerat, edhe pyetje përkitazi me shikimin e këtyre incizimeve në ditën e marrjes së tyre nga ana e policisë, por se nuk është e qartë nëse ai është ballafaquar me këto incizimet në shqyrtim gjyqësor për tu pyetur nëse mund të identifikoj personin në këtë video. Po ashtu rrjedh se janë dëgjuar edhe dëshmitarët R.Z dhe S.T të cilët kanë pasur konflikt të drejtpërdrejt me të pandehurin, një kohë relativisht të shkurtë nga koha e ngjarjes kritike, por që nuk rezulton se ata nuk janë dëgjuar përkitazi me rrethanat e shikimit të këtyre incizimet të marra nga pompa e derivate-vendit të ngjarjes andaj, rezulton se nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë ky fakt me rëndësi, e cila sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë është prova kryesore në këtë çështje penale, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar lidhur me këtë gjykata ka theksuar se nga Laboratorët e Policisë nga shtetet tjera kanë dhënë përgjigjen e pamundësisë për të pastruar imazhet me qëllim të identifikimit të kryesit që shihet në këtë video incizim.

Në anën tjetër nga shkresat e lëndës rrjedh se i pandehuri kishte dëshmuar se për nevojat e tij e kishte shfrytëzuar automjetin “Hamer”, dy ditë më parë, respektivisht ....., ku kishte lëvizur nga shtëpia e tij për në qytetin e Pejës, duke frekuentuar edhe disa markete-qendra tregtare, ku për të vërtetuar këtë fakt Policia e Kosovës kishte marrë incizimet e kamerave të këtyre marketeve, nga të cilat kanë konfirmuar- vërtetuar praninë e të pandehurit në këto markete në kohën e pretenduar nga i pandehuri.

Meqenëse në këtë çështje penale nga ekspertizat e kryera në vendet jashtë Kosovës ka rezultuar se nuk kanë mundur të pastrojnë imazhet e kryesit-personit që shihet në incizimin e marra nga kamerat nga vendi i ngjarjes në pompën “D-P.” të ditës kritike, gjykata e shkallës së parë në rivendosje duhet që të kërkoj nga ekspertët pranë AFK-ës, e në bashkëpunim edhe me laboratorin e Policës së Kosovës apo edhe me ndihmën e laboratorëve-agjencive forenzike jashtë Kosovës, të kryej ekspertizën për të vërtetuar apo eliminuar përputhshmërinë apo ngjashmërinë në fizionomi-fizikun ndërmjet personit që shihet në video të marra në vendin e ngjarjes në pompën “D-P.” dhe video-incizimit të marrë nga Policia në marketet ku kanë konfirmuar praninë e të akuzuarit në këto incizimet së bashku me materialet-foto tjera të nevojshme për krahasim, krejt këtë për të vërtetuar në mënyrë të plotë këtë fakt vendimtar në këtë çështje penalo-juridike.

Gjykata e Apelit vëren se nga arsyetimi i aktgjykimit, fq.49, pasuesi i parë të ketë konstatuar se *“përkundër kësaj, nuk rezulton se ka pas gjurmë të tij (është fjala për të ndjerin I.K) në këtë kapak, as gjurmë të gishtërinjve e as gjurmë të ADN-së, mirëpo nga procesverbali i shqyrtimit*

gjyqësor kuptohet se gjatë ekspertimit nuk është bërë krahasimi edhe për ADN e të ndjerit, por vetëm të profileve dhe mostrave të marrë për të akuzuarin dhe dy dëshmitarëve tjerë në atë kohë të dyshuar në këtë çështje penale, andaj për të vërtetuar këtë fakt duhet të kërkohet që të bëhet edhe kjo ekspertizë, duke kërkuar nga Instituti i mjekësisë ligjore, nëse të njëjtit kanë mostrat e ADN-së e të ndjerit me qëllim që të vërtetohet edhe ky fakt i rëndësishëm për këtë çështje penale.

Nga të lartcekura ankesa e Prokurorisë Themelore është aprovuar si e bazuar ndërsa për të këto arsytet përgjigjja në ankesë është refuzuar si e papabazuar meqenëse aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Në rigjykim Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojnë në pajtim me vërejtjet e lartcekura, t'i eliminojë të gjitha shkeljet e cekura, t'i administrojë të gjitha provat, dhe të njëjtat t'i vlerësojë në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPPRK-së dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e mandej të merr vendim të drejtë dhe ligjor.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 402 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda**  
**PAKR.nr.39/2022 më datë 26.01.2023**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

**Anëtarët e kolegjit**

**Kryetare e kolegjit**

\_\_\_\_\_  
**Syzana Goxhuli**

\_\_\_\_\_  
**Vaton Durguti**

\_\_\_\_\_  
**Tonka Berishaj**

\_\_\_\_\_  
**Bashkim Hyseni**